

NEWSLETTER E DIASPORËS

PËRFAQËSIMI DHE NXITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE TË NDERVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT,
DUKE NXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE SHTETET KU ATA BANOJNË

#10

Mbledhja e fundit e grupit ndërinstitucional për masën 51, prezantohet koordinatori kombëtar për informimin e Diasporës

Sot u zhvillua mbledhja e fundit e grupit ndërinstitucional të punës për zbatimin e masës 51 të planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën, për të prezantuar koordinatorin shtetëror për informimin e Diasporës, z.Fatjon Hallkaj.

Drejtori i Programimit dhe Zhvillimit, në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), z. Fatjon Hallkaj do të mbikëqyrë zbatimin e masës 51, të planit të veprimit, të Strategjisë Kombëtare për Diasporën, miratuar me vendim nr.259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave.

Në funksion të kësaj mase ai do të vlerësojë dhe koordinojë punën për informacionin që publikohet në seksionin e dedikuar për Diasporën në faqet elektronike të institucioneve të administratës shtetërore për interesat e komunitetit shqiptar jashtë vendit.



Ministri takim me përfaqësues të Partneritetit të Qeverisë së Hapur (OGP)



Ministri i Shtetit për Diasporën z. Pandeli Majko priti në një takim z. Joe Powell, zëvendës Drejtori i Përgjithshëm i Partneritetit të Qeverisë së Hapur (OGP) si dhe znj. Sandra Pernar, Koordinatore Rajonale për Europën e Partneritetit të Qeverisë së Hapur.

Qëllimi i kësaj vizite të përfaqësuesve të OGP-së ishte vlerësimi i mundësive të bashkëpunimit. Ministri Majko shprehu interesimin e tij për të bashkëpunuar me ekipin e OGP, gjithashtu sugjeroi që të punohet ngushtë me Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës. Gjatë takimit ministri bisedoi me përfaqësuesit e OGP edhe për Samitin II të Diasporës.

<https://diaspora.gov.al/ministri-takohet-me-perfaqesues-te-organizates-partneritetit-te-qeverise-se-hapur>

TAKIMI I RADHËS PËR
PËRGATITJEN E
PLATFORMËS SË
PROGRAMEVE TË
POSAÇME NË RTSH
DIASPORA



Në takimin e radhës së grupit ndërinstitucional të punës për përgatitjen e Platformës së programeve të emisioneve të posaçme për mësimin e gjuhës shqipe, kulturën shqiptare dhe identitetin kombëtar u diskutua mbi projektet konkrete të cilat do të përgatiten dhe transmetohen në RTSH Diaspora. Gjatë mbledhjes u diskutua për emisione të cilat do të dedikohen target grupeve të ndryshme në komunitete shqiptare në botë.



Mbledhja e radhës e Këshillit Drejtues të Agjencisë Kombëtare të Diasporës, diskutohet raporti vjetor 2018, aktivitet e zhvilluara dhe pasqyra financiare

Këshilli Drejtues i Agjencisë Kombëtare për Diasporën mbajti ditën e sotme mbledhjen e radhës e cila u drejtua nga kryetari i këtij këshilli z. Etjen Xhafaj, zv.ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme. Gjatë kësaj mbledhjeje u diskutua Raporti Vjetor i Agjencisë Kombëtare të Diasporës. Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë, z. Dritan Delija prezantoi Raportin Vjetor për vitin 2018, duke u ndalur në aktivitetet e zhvilluara gjatë vitit 2018 si dhe aktivitetet që do të zhvillohen në përputhje me planin e punës gjatë vitit 2019.

Në përfundim të diskutimeve Këshilli Drejtues miratoi me vendimin Nr. 2, datë 18. 03. 2019 "Për miratimin e Raportit Vjetor 2018, Aktivitetet e Zhvilluara dhe Pasqyrës Financiare", Raportin Vjetor për vitin 2018.

<http://akd.gov.al/mbledhja-e-radhes-e-keshillit-drejtues-te-agjencise-kombetare-te-diaspores-diskutohet-raporti-vjetor-2018-aktivitet-e-zhvilluara-dhe-pasqyra-financiare>

Këshilli Drejtues i Fondit Shqiptar të Diasporës miraton raportin vjetor

Këshilli Drejtues i Fondit Shqiptar të Diasporës mbajti mbledhjen e radhës ku miratoi raportin vjetor. Në këtë mbledhjeje u diskutua rreth aktivitetit të kryera të Fondit Shqiptar të Diasporës gjatë vitit 2018. Antarët e Këshillit diskutuan raportin e FSHZHD për 2018, analizuan shpenzimet e Fondit Shqiptar të Diasporës si dhe situatën e buxhetit. Në mbledhjeje u fol edhe për disa nga bashkëpunimet aktuale dhe mundësitë për bashkëpunime të reja.

